



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim dhe Interpretim B-C / C-B

Ngarkesa në orë/kredite: 40 orë mësimore; 4 kredite; 20 seminare; 20 leksione
Viti / Semestri: Viti III, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe Interpretim në gjuhën greke dhe angleze”
Kodi i etikës : Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objekti i përgjithshëm lëndor: Lënda synon të pajisë studentët me njohuri teorike dhe aftësi praktike për përkthimin dhe interpretimin midis gjuhëve B dhe C, përmes zhvillimit të kompetencave të analizës së tekstit, zbatimit të strategjive përkthimore dhe reflektimit mbi etikën profesionale të përkthyesi

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohë dhe të kuptojë përkthimin si një proces funksional dhe komunikativ, përtej përkthimit të fjalëpërfjalshëm.
2. Të përvetësojë rolin e përkthyesit si aktor i ndërmjetësimit kulturor dhe gjuhësor, duke marrë vendime në mënyrë të ndërgjegjshme dhe profesionale.
3. Të analizojë dhe të trajtojë probleme tipike të përkthimit (terminologji, frazeologji, dallime kulturore, struktura gjuhësore).
4. Të mësojë përdorimin e burimeve të jashtme (fjalorë, korpuse, glosarë tematikë) për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve përkthimore.
5. Të zhvillojë shprehje për rishikimin dhe redaktimin kritik të teksteve të përkthyer.

Rezultatet e pritshme të nxënësit:

1. Në përfundim të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të:
2. Analizojnë dhe zbatojnë strategji të ndryshme për përkthimin dhe interpretimin midis gjuhëve B dhe C, në funksion të kontekstit, qëllimit dhe audiencës së synuar.
3. Identifikojnë dhe zgjidhin problemet e përkthimit që lidhen me terminologjinë, strukturën gjuhësore dhe aspektet kulturore, duke përdorur burime të besueshme dhe metoda të përshtatshme.
4. Kryejnë rishikim dhe redaktim të përkthimeve të tyre për të siguruar saktësinë, koherencën dhe përshtatshmërinë e teksteve të përkthyer.